



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i .Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare, Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve, Komisioni i Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 1 / Datë 04.08 .2026

Lenda: “Për miratimin e projekt-dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2027-2029 të Bashkisë Tepelenë”.

Analiza ligjore; Në mbështetje të nenit 41 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2025 të Ministrit të Financave “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor”, të shkresës së Ministrisë së Financave nr.10436, datë 16.06.2026, si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.21, datë 30.03.2026 “Për miratimin e parashikimeve të të ardhurave dhe tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029”, paraqitet për shqyrtim dhe miratim Dokumenti i Parë i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029 i Bashkisë Tepelenë.

Situata aktuale e funksionit: Ky relacion hartohet me qëllim informimin e Këshillit të Bashkisë Tepelenë mbi përmbajtjen e Dokumentit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029, argumentimin e parashikimeve financiare dhe paraqitjen e prioriteteve të zhvillimit të bashkisë për periudhën afatmesme.

Dokumenti synon:

- të sigurojë një planifikim financiar realist dhe të qëndrueshëm;
- të garantojë përdorimin me eficiencë, efektivitet dhe transparencë të fondeve publike;
- të orientojë burimet financiare drejt prioriteteve strategjike të zhvillimit vendor;
- të krijojë bazën për hartimin e buxheteve vjetore të viteve 2027, 2028 dhe 2029;
- të harmonizojë prioritetet e Bashkisë Tepelenë me politikat kombëtare të zhvillimit dhe programet e financimit.

II. Përmbajtja e Dokumentit të Parë të PBA 2027–2029

Dokumenti i Parë i Programit Buxhetor Afatmesëm përfshin:

- analizën e të ardhurave të programuara dhe burimeve të financimit;
- planifikimin e shpenzimeve sipas programeve buxhetore;
- planifikimin e shpenzimeve sipas natyrës ekonomike;
- planifikimin e investimeve kapitale për periudhën 2027–2029;
- numrin maksimal të punonjësve dhe ndikimin e tij në buxhet;
- analizën e risqeve fiskale dhe masat për administrimin e tyre;
- projektet me financim dhe bashkëfinancim nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare;
- rekomandimet e Ministrisë së Financave mbi përmirësimin e planifikimit buxhetor.

III. Procesi i hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm

Hartimi i Dokumentit të Parë të PBA 2027–2029 është realizuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe metodologjinë e përcaktuar nga Ministria e Financave.

Procesi ka përfshirë:

- analizën e realizimit të buxhetit të viteve të mëparshme;
- vlerësimin e të ardhurave të veta dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit;
- përcaktimin e tavanëve buxhetore për çdo program;
- konsultimin me të gjitha drejtoritë dhe njësitë shpenzuese të Bashkisë;
- identifikimin dhe prioritizimin e investimeve kapitale;
- harmonizimin e planifikimit financiar me Strategjinë e Zhvillimit Vendor dhe dokumentet sektoriale.

Gjatë hartimit të dokumentit janë marrë në konsideratë nevojat e komunitetit, objektivat e zhvillimit ekonomik e social të Bashkisë Tepelenë, si dhe kufizimet financiare që lidhen me burimet e disponueshme për periudhën afatmesme.

Dokumenti është ndërtuar mbi parimet e disiplinës fiskale, transparencës, qëndrueshmërisë financiare, përgjegjshmërisë në administrimin e fondeve publike dhe orientimit të shpenzimeve drejt rezultateve konkrete në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

Situata financiare : (sipas dokumentacionit/relacionit që e shoqëron projektvendimin) _____

Monitorimi dhe raportimi :

Drejtorise e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

Impakti social / grupet që preken:

Qytetarë të Bashkisë Tepelenë

A është objekt i konsultimit publik: po realizuar

Komisioni i Përhershëm. Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare, Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit,

Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve, Komisioni i Ekonomisë Vendore, Turizmit dhe Zhvillimit Rural, i mbledhur me datën 04.08. 2026, shqyrtoi projekt vendimit: “Për miratimin e projekt-dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2027-2029 të Bashkisë Tepelenë”.


Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materiale shoqëruese, Komisioni me shumicë votash,


VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- ☒ a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon;

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

 Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

 Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)



Datë 04.08. 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKAK

Model : Proçes-verbali i Mbledhjes së Komisionit të Përhershëm të Këshillit

Data e mbledhjes së Komisionit 04.08.2016

Ora e hapjes së mbledhjes 10.00

Marrin pjesë : 1. _____ këshilltar- kryetar i komisionit
2. Lotif Kary këshilltar – zv-kryetar i komisionit
3. Vledimir Gjony sekretar i komisionit
4. _____ anëtar
5. _____ anëtar

Marrin pjesë gjithashtu : Këshilltarë / pjestarë të sekretariatit

1. Arben Gjony
2. Hallor Gjony
3. _____

Nga ekzekutivi marrin pjesë :

1. Spilho Kary
2. _____

Kryesuesi i mbledhjes është Z/Zj. _____

Kryetari i Këshillit/ Kryesuesi i mbledhjes **deklaroi kuorumin** prej _____ Këshilltarësh.

Deklarimi i **konfliktit të interesit** : _____

Pika 1 e rendit të ditës.

Projekt-vendim (titulli) “Për miratimin e projekt-dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2027-2029 të Bashkisë Tepelenë”.

Drejtuesi i komisionit prezanton projekt-vendimin

Pyetje (nga këshilltarët)

Ulergjme pefhijer e projektet me bashkifinancim
 dhe dyentimin e fondeve detyrues ne ndihim
 per dyktoret

Përgjigje / sqarime nga ekzekutivi

Propozime nga këshilltarët:

Këshilltari _____ deklaroi / propozoi _____
Këshilltari _____ deklaroi / propozoi _____
Këshilltari _____ deklaroi / propozoi _____

Hidhen në votë propozimet për amendim të projekt-vendimit :

Propozim 1 : Vota PRO — Kundra — Abstenim ✓ Miratohet / Nuk miratohet
Propozim 2 : Vota PRO ✓ Kundra — Abstenim ✓ Miratohet / Nuk miratohet
Propozim 3 : Vota PRO — Kundra — Abstenim ✓ Miratohet / Nuk miratohet

Mbyllet diskutimi.

Përgatitet Raporti i mbledhjes së Komisionit për çdo projekt-vendim që do t'i paraqitet këshillit ne seancë. Raporti u përgatit nga Kryetari / zëvendëskryetari i Komisionit/ sekretari i Komisionit

Lexohet Raporti nga Kryetari / zëvendëskryetari (për çdo projekt-vendim)

Votohet Raporti (1) : Votimi u bë i hapur/ fshehtë – (për çdo projekt-vendim)

U votua raporti Projekt vendim 1: PRO 2 KUNDER — ABSTENIM — - Miratohet / Nuk miratohet

Mbyllet mbledhja e Komisionit

Ora e mbylljes së mbledhjes 10.30.

Kryetari i Komisionit



Sekretari i Komisionit

